



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.200, datë 18.06.2021

PËR TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 46 pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Z. Gjergji Ceka**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, transferohet përkohësisht me pëlqimin e tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.
2. Z. Gjergji Ceka do të ushtrojë detyrën si Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, përkohësisht nga data 01.07.2021 - 30.06.2022.
3. Të njoftohen për këtë vendim Z. Gjergji Ceka, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.
4. Efektet financiare sipas parashikimeve të nenit 15/2 të Ligjit nr. 96/2016, fillojnë në datë 01.07.2021.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

